



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**  
**MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA**  
**MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS**

**KOSOVO CENTER FOR PUBLIC SAFETY EDUCATION AND DEVELOPMENT**  
**QENDRA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE EDUKIM DHE ZHVILLIM**  
**KOSOVSKI CENTAR ZA JAVNU BEZBEDNOST OBRAZOVANJE I RAZVOJ**

---

Duke u bazuar në rregulloren 2001/36, Urdhëresën administrative 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/01, Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtrri shpallë:

## K O N K U R S

**Titulli i vendit të punës:** Udhëheqës i Departamentit të Administratës dhe Logjistikës

**Departamenti:** DA

**Mbikëqyrësi:** Drejtori Ekzekutiv i QKSPEZH

**Kohëzgjatja e kontratës:** Sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil

**Paga mujore:** 326.00 €

**Koeficienti 10**

**Vendi:** Vushtrri

**Përshkrimi i vendit të punës:**

- Vendi i punës do të jetë në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtrri

Udhëheqësi i administratës do të menaxhoj administratën e Qendrës duke përfshirë personelin e administratës dhe buxhetin:

Kompetenca për mbikëqyrje të përgjegjësive për 6 sektorë brenda departamentit të administratës statusore, buxhetore.

- Shefit të sektorit për shërbime të përgjithshme, shefit të sektorit për financa, shefit të sektorit për personel, shefit të sektorit për teknologji informative, shefit të sektorit për sigurim, shefit të sektorit për mjekësi dhe shefit të transportit.

### **Detyrat kryesore:**

- Përcakton dhe zbaton procedurat Standarde të Administratës Publike të Kosovës që lidhen me financa, personel, prokurim.
- Ndan fonde në pajtim me buxhetin e miratuar të QKSPEZH, monitoron zbatimin e buxhetit, identifikon mospërputhjet dhe propozon zgjidhje.
- Siguron respektimin e politikave financiare dhe të procedurave.
- Përgatit buxhetin vjetor.
- Mbikëqyrë dhe vlerëson punën brenda Departamentit të Administratës.

### **Shkathtësitë kryesore, njohuritë, aftësitë e kërkuara – ju lutemi t'i saktësoni si qenësore ose të dëshirueshme:**

- Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe me orar të gjatë, janë esenciale
- Përvojë profesionale në fushën e ekonomikut/menaxhimit, administrimit;
- Aftësi të mira komunikuese dhe koordinuese në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e personelit vartës;
- Aftësi dhe gatishmëri për të punuar me njerëz të përkatësive të ndryshme kulturore dhe religjioze;

### **Kualifikimet edukative dhe profesionale për post – ju lutemi të specifikoni esenciale ose të dëshirueshmet:**

- Përgatitje Universitare
- Përvojë në Mbikëqyrje dhe Udhëheqje
- Përvojë pune 4 vjet
- Përvojë relevante në fushën e administratës

**Titulli i vendit të punës: Udhëheqës i Departamentit për Mbështetje Programore**

**Departamenti: DPM**

**Mbikëqyrësi: Drejtori Ekzekutiv i QKSPEZH-it.**

**Kohëzgjatja e kontratës. Sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil**

**Paga mujore: 326.00€**

**Koeficienti 10**

**Vendi: Vushtrri**

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Kompetenca për Mbikëqyrje të :

- Shefit të Sektorit për Standarde Trajnuese
- Shefit të Sektorit për Materiale Trajnuese
- Shefit të Sektorit për Administrimin e Kurseve
- Shefit të Sektorit për Mbështetje Gjuhësore

Përshkrimi i vendit të punës:

- Vendi i punës do të jetë në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtrri. Qendra është përgjegjëse për trajnimin e personelit të agjensioneve të sigurisë publike në Kosovë. Departamenti për Mbështetje Programore (DMP) krijon shtyllën teknike mbështetëse të QKSPEZH-it. Si e tillë, ofron një varg shërbimesh të cilat i japin policisë dhe grupeve tjera për siguri publike, ndihmë dhe zhvillim të suksesshëm, në programet e tyre trajnuese.

Detyrat kryesore:

- Mbikëqyrë dhe vlerëson punën brenda Departamentit për Mbështetje Programore
- Zhvillon kapacitetin e programit, menaxhimin dhe vlerësimin e trajnimeve profesionale
- Përforcon kualitetin brenda mekanizmit kontrollues dhe shfrytëzon rezultatet e analizave për kompletimin e mungesave në rregullore dhe përqendrimin në trajnim.
- Mban lidhje me menaxhmentin e QKSPEZH-it dhe agjensionet tjera të jashtme, për siguri publike, me qëllim të zhvillimit dhe mbështetjes së programeve trajnuese.
- Shërben si pikë kontaktuese e QKSPEZH-it me agjencinë të jashtme, për të gjitha çështjet lidhur me trajnim.

Përgjegjës për: ( përgjegjësi udhëheqëse për 5 Sektorë brenda DMP, statusore, buxhetore)

Aftësitë kryesore, njohuritë, shkathtësitë e kërkuara, ju lutem i specifikoni esenciale ose të dëshirueshmet:

- Fleksibilitet dhe aftësi për të punuar nën presion dhe me orar të gjatë, janë esenciale.
- Njohuri të forta organizative dhe koordinim janë esenciale.
- Aftësi për të punuar me njerëz të kulturave, gjinive dhe feve të ndryshme dhe pikëpamjet e ndryshme politike që krijon paanësi dhe objektivitet, është esenciale.
- Aftësi të shkëlqyeshme komunikuese dhe ndër personale në gjuhën Angleze, e po ashtu në gjuhët vendore është esenciale.
- Vetë-iniciativë dhe përkujdesje për hollësira, është esenciale.
- Aftësi për të punuar në rrethana ekipore, është esenciale.

Kualifikimet edukative dhe profesionale për post, ju lutem specifikoni esenciale ose të dëshirueshmet:

- Përgatitje Universitare
- Përvojë e përshtatshme në Udhëheqje të Personelit, Edukim dhe Mësim për të Rriturit
- Përvojë në Mbikëqyrje dhe Udhëheqje së paku 5 vjeçare
- Përvojë në mësimdhënie/trajnim, të pjesëtarëve të sigurisë publike
- Njohja e gjuhëve zyrtare e obligueshme ( Serbe , Angleze )

**Paraqitja e kërkesave:** Formularët e kërkesave mund të merren dhe të dorëzohen në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim respektivisht (ish shkolla policore) në zyrën e personelit me adresë Rr. Skënderbeu pn 42000, Vushtrri.Data e mbylljes së kërkesave 15 ditë pas shpalljes në ndonjë nga gazetatat zyrtare të Kosovës.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim nuk do të merren parasysh ndërsa kërkesat e pakompletuara dhe ata te cilet nuk i kane kualifikimet adekuate nuk do te meren parasyeshe dhe nuk do të shqyrtohen dhe pranohen.

Tel. Kontaktues 028/570-008 lok 114 në rast të ndonjë paqartësie dhe këshille.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të ftohen për intervistim.

**Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve në Kosovë.**